

## AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI

### I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUARA

“VALE GROUP” Sh.P.K.

#### Neni 1

##### Emërtimi dhe ortakët e Shoqërisë

Sot, në Tiranë, në datën 6 Mars 2018 me vullnetin e lirë Ortaku i Shoqërisë:

Valentina Kondakçiu me numër identifikimi **F85703055T**, lindur më 03.07.1958, banues në rrugën “Bilal Golemi”, Tirane.

Vendosi: Të themelojë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar emërtimi i së cilës do të jetë “VALE GROUP” SH.P.K. , më poshtë e quajtur si “Shoqëria”

#### Neni 2

##### Selia e Shoqërisë

Shoqëria do ta ketë selinë e saj në qytetin e TIRANËS, Rrugen “Bilal Golemi”, Pallati 45, Hyrja 3, kati 7, apartamenti 26, por me Vendimin e Asamblesë së Ortakëve, mund të ngrihen edhe degë, filiale apo dhe seli në vende të tjera, brenda dhe jashtë territorit të Shtetit Shqiptar.

#### Neni 3

##### Kohëzgjatja e Veprimtarisë

Kohëzgjatja e veprimtarisë do të jetë 20 vjet të njëpasnjëshëm, por me Vendim të Asamblesë së Ortakëve, ky afat mund të ripërtërihet.

#### Neni 4

##### Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 100 (nje qind lekë), te cilat perfaqesojne 100% te kapitalit (nje kuote), ku 100% i perkasin ortakes Valentina Kondakciu, i cili është tërësisht kapital financiar që përbëhet nga kontributi i ortakëve të kompanisë.

Ortakët kanë të drejtë ta tjetërsojnë këtë kapital, të shtojë apo të pakesojë kuotat e kapitalit deri në kufijtë e përcaktuara nga ligji.

Secili ortak disponon një kuotë në Shoqëri. Asnjë nga ortakët nuk mund të transferojë kuotën përkatëse të pjesëmarrjes në Shoqëri pa miratimin paraprak me shkrim të ortakëve të tjerë. Në rast se një nga ortakët dëshiron të kalojë/transferojë plotësisht apo pjesërisht kuotën e tij në Shoqëri, duhet t'ia ofrojë këtë kuotë për blerje ortakëve të Shoqërisë. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga ofrimi i kuotës për blerje, ortakët do të kenë të drejtën të blejnë kuotën e

ofruar në shitje sipas çmimit dhe mënyrave të pagesës për të cilat kanë rënë dakord me ortakun shitës.

Në rast zmadhimi apo zvogëlimi të kapitalit themeltar të Shoqërisë ortakët do të kenë të drejtë me pjesëmarrjen që zotëron secili në kapitalin e Shoqërisë.

## Neni 5

### Objekti i Veprimtarisë

#### Objekti i veprimtarisë së kësaj Shoqërie do të jetë:

Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë por pa u kufizuar në:

- Të ndermarrë veprimtari biznesi si një shoqëri e përgjithshme financiare dhe tregtare, duke përfshirë, por jo duke u limituar vetëm në shërbime web financiare dhe tregtare në bashkëlidhje me njëra - tjetrën ose si sipërmarrje të ndara dhe të dalluara të të gjithave ose vetëm të ndonjerës nga si me poshtë vijon: komisionere, financiare, agjentë financiarë, kandidat, administrues i besuar, agjent, përmbarues, administrator, marrës për llogari, ose në të kundërt, në emër të korporatave private ose publike, shoqërive ose personave. Të sigurojë shërbime në ndërlidhje këtu, qoftë si një biznes i vetëm, qoftë si biznese të dallueshme dhe të ndara, në ccdo anë të globit.
- Projektimi dhe realizimi i fushatave publicitare dhe promovuese nëpërmjet shfrytëzimit të të gjitha instrumentave, përfshirë marketingun telefonik dhe instrumenta të tjera të marketingut të drejtpërdrejtë; Projektimi, realizimi dhe shitblerja e shërbimeve të call center, si inbound dhe outbound.
- Projektimi, administrimi dhe shitblerja e produkteve dhe shërbimeve telematike, informatike dhe të marketingut, në fushën telefonike, informatike dhe tregtare; Administrimi dhe tregtimi i bankave të të dhenave të finalizuara për marketing; Përfaqësimin dhe shërbime në fushën e telekomunikacioneve dhe të prodhimeve e shërbimeve telematike.
- 

Për të realizuar objektin e aktivitetit të saj, Shoqëria mund të veprojë në Shqipëri dhe jashtë, dhe të kryejë ccdo aktivitet tjetër të nevojshëm, të lidhur, instrumental, të perafert, elementar, ose sidoqofte të dobishëm, për shembull:

- Të ofrojë garanci reale dhe/ose personale si për detyrime të vetat, ashtu edhe për të tretët. Të marrë përsipër, të lejojë dhe/ose të heqë dorë nga pjesëmarrje direkte ose indirekte në shoqëri të tjera dhe ndërmarrje, si Shqiptare ashtu edhe të huaja, që kryejnë veprimtarinë e tyre ana tyre, me qëllim që të lehtësojnë realizimin e objektit social; Veprimtari tregtare dhe industriale, import dhe eksport të mirash, shërbimesh dhe produkteve.

Me zgjerimin e aktivitetit, shoqëria mund të bëjë shtesa të ndryshme ose ndryshime të objektit të veprimtarisë së saj, duke bërë ndryshimet përkatëse në Statut.



## Neni 6

### Kalimi i kuotave me trashëgimi (Mortis Causa) ose për shkak të Falimentimit të ortakut

Në rast vdekje apo falimenti të njërit prej ortakëve, kalimi i kuotës dhe i të drejtave përkatëse në favor të trashëgimtarëve apo personave që fitojnë këro të drejta duhet të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme, e cila duhet të shprehet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi i vdekjes apo i falimentimit të ortakut. Në rast të refuzimit të pëlqimit apo nëse Asambleja e Përgjithshme nuk është shprehur brenda afatit të sipërpërmendur, Shoqëria do t'ju paguajë trashëgimtarëve apo personave që fitojnë këto të drejta vlerën e kuotës që do të përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme, duke patur parasysh gjendjen pasurore të Shoqërisë dhe vlerën e tregut të kuotës.

Personi që fiton të drejtën mbi kuotën e pjesëmarrjes për shkak të vdekjes apo falimentimit të një ortakut mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të zgjedhur prej tij si përfitues i kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotërues i kuotës, ai njofton Shoqërinë në lidhje me këtë vendim.

Personi që fiton të drejtat mbi një kuotë për shkak të vdekjes apo falimentimit të një ortakut do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit si zotërues i kuotës.

## Neni 7

### Zmadhimi i Kapitalit

Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë kapitalin e Shoqërisë. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do t'i komunikohet me shkrim ortakëve që janë thirrur, nëse nuk janë të pranishëm në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme që vendosi zmadhimin e kapitalit.


Në rast zmadhimi të kapitalit, të gjithë ortakët do të kenë të drejtën të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit, në para ose me kontribute në natyrë, në përpjestim të drejtë me kuotat e pjesëmarrjes në Shoqëri.

Në rast se disa ortakë heqin dorë nga e drejta e nënshkrimit të pjesës së tyre, kapitali i panënshkruar prej tyre mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë. Në këtë rast, këta ortakë mund të ushtrojnë sërish të drejtën për nënshkrimin e kapitalit, në përpjestim të drejtë me kuotat e pjesëmarrjes në Shoqëri.

## Neni 8

### Zvogëlimi i Kapitalit

Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 9 të këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Në çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e përcaktuar me ligj.





Ortakët e përballojnë zvogelimin e kapitalit të shoqërisë, në përpjetim të drejtë me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë.

## Neni 9

### ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Asambleja e përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi të gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Akti Themelimi dhe Statuti dhe/ose çdo marrëveshje midis ortakëve të Shoqërisë.

Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e tij si dhe të votojë në përputhje me pjesët e kapitalit që ai zotëron në Shoqëri.

Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një person tjetër, me prokurë më shkrim.

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike (conference call) audio ose video, në përputhje me ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe ligjin për Komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të hartohet dhe të nënshkruhet procesverbali përkatës.

Asambleja e përgjithshme mund të thirret nga Administratorët ose nga ortakët në baze të nenit 84 të ligjit nr .9901 datë 14.04.2008 “Mbi ndërmarrjet dhe Shoqëritë Tregtare”. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose me mjete elektronike, dërguar secilit prej ortakëve në adresat e njoftuara Shoqërisë të paktën 7 (shtatë)ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes.

Asambleja e përgjithshme do të mbledhet rregullisht, pavarësisht nga këto formalitete, kur ortakët apo përfaqësuesit e tyre janë të pranishëm dhe bien dakord të vendosin në lidhje me rendin e ditës.

Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Administratorët. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje ndër personat e pranishëm.

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakëve, vendimet duhet të përfshijnë dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.

Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Asambleja e Përgjithshme, përveçse për sa parashikon neni 9 i këtij Akti themelimi dhe Statuti, për vendime që kërkojnë shumicën e zakonshme, merr vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët më të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre, që zotërojnë më shumë se 30 % (tridhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë, sipas nenit 86 pika I, të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Mbi ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare”.



## Neni 10

### Administratori

1. Shoqëria do te administrohet dhe perfaqesohet nga një Administrator e cili do të jetë **Valentina Kondakçiu**, me atësi Vasil dhe amësi Sofie, dtl 03.07.1958, lindur në Kasimbejas, Lushnjë, Shqipëri dhe me banim në Tiranë.

Asministratori /t zotëron kompetenca të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha aktet që konsideron të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë, përveç veprimeve, përmbushja e të cilëve i rezervohet Asamblesë së Përgjithshme apo organeve të Shoqërisë. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë dhe mund të autorizojë persona të tretë, për të përmbushur veprime të caktuara, në emër dhe për llogari të Shoqërisë. Në çdo rast administratori do të jetë përgjegjës për veprimet e të tretëve të autorizuar.

Asambleja e përgjithshme vendos shpërblimin e administratorëve te Shoqërisë.

## Neni 11

### Shpërbërja dhe likuidimi

Shoqëria shpërbëhet për arsyet e parashikuara nga ligji:

- a. Për mbarimin e afatit.
- b. Për pamundësi të funksionimit ose për inaktivitet të vazhduar të asamblesë,
- c. Për reduktimin e kapitalit nën minimumin ligjore.
- d. Me vendim të asamblesë e për arsye të tjera të parashikuara me ligj

Në të gjitha hipotezat e shpërbërjes, asambleja e ortakëve, do të caktojë një ose më shumë likuidatorë duke percaktuar numrin e likujdvesve si dhe kriteret në bazë të të cilave do kryhet likuidimi.

## Neni 12

### Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon dhe mbaron në 31 Dhjetor të çdo viti.

## Neni 13

### Kontrolli Financiar

Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet nga Ekspertë Kontabël të Autorizuar, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo me shumë Ekspertë Kontabël të Autorizuar në atë rast kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

## Neni 14

### Bilanci Vjetor





Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, raportet e organit administrativ mbi ecurinë e veprimtarisë sociale dhe të ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

#### **Neni 15**

#### **Dividentët**

Në përputhje me dispozitat ligjore, Asambleja e Përgjithshme vendos mbi shpërndarjen e dividentëve në bazë të rezultatit financiar të shoqërise.

#### **Neni 16**

#### **Gjuha**

Ky Akt Themelimi u nënshkrua në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe.

#### **Neni 17**

#### **Dispozita përfundimtare**

Shoqëria do të kryejë veprimtarinë e saj me këtë Akt Themelimi dhe Statut dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Për sa nuk parashikohet në këtë Akt themeli dhe Statut, do të zbatohen parashikimet e ligjit nr.9901 i datës 14.04.2008 "Mbi ndërmarrjet dhe Shoqëritë tregtare".

Ortakët:

**Valentina Kondakçiu**

